



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 602/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazić dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore gjatë ditës së zgjedhjeve, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN).

Arsyetim

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013 në qendrën e votimit 0314e në shkollën fillore “Jusuf Gërvalla” në fshatin Negroc komuna e Drenasit rreth orës 11:30 një veturë me flamuj të PDK-së ka hyrë në oborrin e shkollës. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e menaxherit dhe komisionarëve të kësaj qendre të votimit si dhe fotografën nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesë pretendon se militantë të subjektit politik PDK me flamuj të subjektit të tyre kanë hyrë në oborrin e shkollës fillore Jusuf Gërvalla ku ka qenë duke u votuar, PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se nga fotot e ofruara si dëshmi nuk shihet shkolla për të cilën pretendon pala ankuese në ankesën e saj dhe se këto prova nuk janë të mjaftueshme për tu vërtetuar pretendimet e tilla andaj një ankesë e tillë është e pabazë dhe se një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si përgjithshëm dhe i pa argumentuar mirë në fakte dhe në dëshmi konkrete bindëse. Andaj PZAP-i duke u mbështetur në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 602/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*